



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u> Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Nr. Prot. Br. Prot. <u>03-02/1242/1</u> Prot No. Data Datum <u>10-05-2017</u> Date PRISHTINË



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.05.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3356/16, për z. Rexhep Leci – Këshilltar Politik në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3356/16, për z. Rexhep Leci – Këshilltar Politik në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Leci, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat “DARK – BLACK SECURITY” SH.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në bazë të cilës fillimisht ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, zyrtarët e Agjencisë kanë kontaktuar zyrtarin e lartë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.



z. Leci është bindur për kufizimet në ushtrimin e funksionit menaxhues në biznesin privat, krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë dhe ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë z. Leci ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ai është larguar nga pozita e pronarit dhe personit të autorizuar në biznesin privat. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

